REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil

Nr. 311. Prot.
Dt. 05.11.2026

Aneksi A

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela 1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervistë	Fillimi	Mbarimi
1	**Inspektor**	AKISA, Tiranë	Tiranë	Pa afat	Po	Po	09.11.2026	19.11.2026

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës: Inspektor
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Institucioni: Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil (AKISA), Tiranë.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: Kategoria e pagës III-1.
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 09.11.2026
8. Data e mbylljes së aplikimit: 19.11.2026
Numri i vendeve: 1 (një)
Raporton te: Drejtori i AKISA-s ose eprori i caktuar sipas strukturës.
9. Mënyra e aplikimit: Kandidatët dorëzojnë dokumentacionin e aplikimit, të plotë dhe brenda afatit të mbylljes (19.11.2026), me email në adresën: denis.kuci@akisa.gov.al. Aplikimet vlerësohen mbi bazën e meritës, kualifikimeve profesionale, përvojës dhe rezultateve në fazat e përzgjedhjes.
10. Dokumentet e aplikimit: Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: ▪ kërkesën/aplikimin për pozicionin; ▪ jetëshkrimin (CV) e përditësuar, me përshkrim të detajuar të përvojës profesionale; ▪ letër motivimi; ▪ fotokopje të kartës së identitetit; ▪ diplomën e shkollës së lartë, të noterizuar, së bashku me listën e notave; ▪ kopje të certifikatave të kualifikimit profesional;

- për kandidatët pilotë: kopje të licencës dhe të ratingeve përkatëse, si dhe dokumentimin e orëve të fluturimit;
- dokumentacionin që vërteton përvojën e punës;
- dëshmi të trajnimeve dhe certifikimeve relevante;
- librezë pune (fotokopje e plotë);
- raport mjekësor;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim i gjendjes gjyqsore ;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- vetëdeklarim për mosekzistencën e pengesave ligjore dhe të konfliktit të interesit me funksionin;
- çdo dokument tjetër që AKISA kërkon gjatë procedurës, ose që kandidati e konsideron relevant për vlerësimin e kualifikimeve dhe të përvojës.

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

a) të ketë shtetësinë shqiptare;
b) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
c) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
d) të jetë i/e aftë për punë nga ana shëndetësore;
dh) të mos jetë i/e dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
e) të mos i jetë dhënë masa disiplinore e largimit nga puna, e cila nuk është shuar;
ë) të ketë integritet të lartë profesional dhe personal dhe të mos ketë konflikt interesi me funksionin;
f) të jetë i/e aftë për të punuar në mënyrë të pavarur, objektive dhe të paanshme;
g) të jetë i/e gatshëm/e për udhëtime të shpeshta dhe për reagim të shpejtë ndaj ngjarjeve që kërkojnë mobilizim.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

a. **Pozicioni:** "Inspektor (Investigator i Operimeve në Fluturim)".

b. **Arsimi:** Arsim i lartë në aviacion, operime fluturimi, inxhinieri aeronautike ose fushë të afërt dhe të lidhur me pozicionin.

c. **Kualifikimi:** Për kandidatët me profil pilot: licencë profesionale, e shoqëruar me diplomën e lartë, dhe përvojë e dokumentuar si pilot profesionist.

d. **Njohuritë:** Njohuri në të paktën 2 prej fushave: SMS, menaxhimi i rrezikut, Human Factors/CRM dhe analiza e raportimit të ngjarjeve.

e. **Eksperienca në punë:** Të paktën 5 (pesë) vjet përvojë profesionale relevante në aviacionin civil: operime fluturimi, flight crew, operator ajror, organizatë trajnimi ose funksion teknik/operacional të krahasueshëm.

f. **Gjuha e huaj:** Të zotërojë gjuhën angleze dhe një gjuhë tjetër të Bashkimit Evropian në nivelin B2 ose më lart, veçanërisht terminologjinë teknike të aviacionit.

g. **Kërkesa të tjera specifike:** Aftësi analitike të theksuara dhe aftësi për të hartuar raporte teknike të qarta, të strukturuara dhe të argumentuara.

Përvoja e preferuar (vlerësohet si avantazh):

- pjesëmarrje në investigime aksidentesh ose incidentesh;
- trajnime në Flight Operations Investigation, Human Factors, CRM, Safety Management Systems ose Flight Recorders;

- përvojë si Investigator, Safety Manager, Flight Operations Manager, Chief Pilot, Instruktor/Examiner ose Flight Dispatcher;
- analizë e të dhënave të fluturimit;
- hartim i raporteve teknike dhe i rekomandimeve të sigurisë;
- njohja e ECCAIRS/ADREP ose e sistemeve të tjera të raportimit dhe analizës së të dhënave të sigurisë;
- bashkëpunim me autoritete homologe të huaja, ICAO, EASA ose organizata të tjera ndërkombëtare.

Përshkrimi i punës: Inspektori (Investigator i Operimeve në Fluturim) punon në investigimet e incidenteve dhe aksidenteve ajrore në aviacionin civil, me fokus te mënyra si kryhet fluturimi: planifikimi, procedurat operative (SOP), puna e ekuipazhit, CRM, faktorët njerëzorë, lodhja, organizimi i punës, si dhe të dhënat teknike të regjistruara nga mjeti fluturues.

Detyrat kryesore:

- Merr pjesë në investigimet e incidenteve dhe aksidenteve ajrore, sipas detyrës së caktuar nga investiguesi në detyrë.
- Merr pjesë në veprimet fillestare në vendngjarje: sigurimi i informacionit, dokumentimi dhe identifikimi i provave.
- Analizon planifikimin e fluturimit, SOP-të, performancën e ekuipazhit, CRM, ngarkesën e punës, lodhjen dhe faktorët organizativë.
- Lexon dhe analizon të dhënat e fluturimit nga regjistruesit e fluturimit, si dhe nga pajisjet e avionikës, radari, ADS-B dhe regjistrimet e tjera relevante, duke i krahasuar me procedurat dhe performancën e pritur.
- Merr, ruan dhe dokumenton provat që lidhen me operimin e avionit, sipas procedurave të AKISA-s.
- Kryen intervista me ekuipazhin, personelin operacional, dëshmitarët dhe persona të tjerë të lidhur me rastin.
- Shqyrton dokumentacionin operacional, teknik dhe të mirëmbajtjes që lidhet me investigimin.
- Bashkëpunon me specialistët e fushave të tjera (mirëmbajtje, avionikë, meteorologji, kontroll trafiku ajror etj.) për analizën e të dhënave.
- Përgatit pjesë të raporteve të investigimit, analizat teknike, konkluzionet dhe materialet mbështetëse.
- Identifikon rreziqet dhe faktorët kontribues dhe merr pjesë në hartimin e rekomandimeve të sigurisë.
- Përfaqëson AKISA-n si anëtar ekipi në investigime të kryera nga autoritete të huaja, kur caktohet.
- Ruan konfidencialitetin e informacionit të investigimit dhe respekton legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.
- Kryen çdo detyrë tjetër të lidhur drejtpërdrejt me funksionin e investigimit, sipas ligjit dhe udhëzimeve të ligjshme të eprorit.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) anëtarë, i ngritur me urdhër të Drejtorit të AKISA-s.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës dhe të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave realizohet nga njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në AKISA, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia verifikon nëse dokumentacioni i aplikantëve është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre, dhe përcakton kandidatët që i plotësojnë këto kërkesa. Verifikohet në veçanti plotësimi i kritereve minimale: arsimin e lartë të kërkuar, përvojën e 5 vjetëve, gjuhën e huaj, si dhe kualifikimet/vërtetimet e aftësive. Për kandidatët pilotë kontrollohet edhe licenca. Kandidatët që nuk i plotësojnë këto kritere nuk kualifikohen dhe njoftohen individualisht. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurrimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse);
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre bëhet nga komisioni përkatës. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

a) 60 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
b) 40 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivimin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar, me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe të eksperiencës. Për këtë pozicion, pyetjet përfshijnë njohuri teknike, analizë rasti, Aneksin 13, procedurat e investigimit, Human Factors/CRM dhe kompetencat e kandidatit.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 40 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë** (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës) s'kualifikohen nga konkurrimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten Drejtorit të AKISA-s, si autoritet vendimmarrës, për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur. Kandidatët e tjerë pjesëmarrës njoftohen për rezultatin.

Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë AKISA-s brenda 3 (tre) ditëve nga njoftimi i rezultatit. Ankesa shqyrtohet dhe kandidatit i jepet përgjigje me shkrim.

14. Periudha e provës dhe trajnimi pas përzgjedhjes:

Kandidati i përzgjedhur i nënshtrohet periudhës së provës prej 3 (tre) muajsh, sipas nenit 144 të Kodit të Punës. Gjatë kësaj periudhe, kandidati vlerësohet për përshtatshmërinë në pozicion.

Kandidati i përzgjedhur, në varësi të përvojës së mëparshme, do t'i nënshtrohet një program të dokumentuar trajnimi dhe kualifikimi si investigator. Programi përfshin, sipas nevojës, trajnimin fillestar, trajnimin bazë të investigimit të aksidenteve dhe incidenteve, on-the-job training (OJT), trajnime të specializuara dhe trajnim periodik, në përputhje me nevojat e AKISA-s dhe udhëzimet e ICAO-s.

15. Baza ligjore:

Procedura zhvillohet në përputhje me:

- Ligjin nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë";
- VKM nr. 739, datë 03.12.2021, "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil dhe rregullat për procesin e investigimit", dhe veçanërisht pikat 6 dhe 7, shkronja "d", të kreut II;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 124/2024, datë 19.12.2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Aneksin 13 të Konventës së Çikagos dhe materialet udhëzuese të ICAO-s për investigimin e aksidenteve dhe incidenteve.

Procedura zhvillohet pa asnjë lloj diskriminimi, në përputhje me nenin 9 të Kodit të Punës dhe legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi. Të dhënat personale të kandidatëve përpunohen vetëm për qëllimet e kësaj procedure dhe ruhen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

DREJTOR I AUTORITETIT

Genc RESULI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AUTORITETI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT PËR SIGURINË E OPERIMIT NË AVIACIONIN CIVIL - TIRANË - MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË